



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 14.05.2014, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9947, datë 07.07.2008 “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar”.
3. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare””.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Blendi Klosi, Bashkim Fino, Ermonela Felaj, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Mark Frroku, Petrit Vasili, Dashamir Peza, Armando Prenga, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Piro Lutaj, Vexhi Muçmataj, Spartak Braho dhe Silva Caka.

Mungojnë:

Keltis Kruja, Tahir Muhedini, Edi Paloka, Kastriot Islami, Oerd Bylykbashi, Fatmir Mediu, Tom Doshi, Gjovalin Bzheta, Nard Ndoka, Arben Ristani, Eduard Halimi, Mhill Fufi dhe Gent Strazimiri.

Të ftuar:

Rudina Bollano – përgjegjëse e Sektorit të Patentave në Drejtorinë e Përgjithshme të Patentave dhe Markave në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Lindita Mëneri – përgjegjëse e Sektorit të Markave, Dizenjove Industriale dhe Treguesve Gjeografikë në Drejtorinë e Përgjithshme të Patentave dhe Markave në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Arvid Uruçi – përgjegjës i Sektorit Juridik në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Ervin Mete – zëvendësministër i Financave

Lindita Rusmali – drejtore e legjislacionit në Ministrinë e Financave

Teuta Baleta – përfaqësuese e AMF-së

Gladiola Hysi – përfaqësuese e AMF-së

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Mirëmëngjesi!

Meqenëse kuorumi plotësohet, hapim mbledhjen e komisionit.

Sot, si pikë të parë të rendit të ditës, kemi projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9947, datë 07.07.2008 “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar”. Ne jemi komision për dhënie mendimi dhe relatore për këtë projektligj është zonja Vasilika Hysi.

Si fillim do të dëgjojmë përfaqësuesin e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, zotin Uruçi. Ju lutem, na bëni një prezantim të shkurtër, sepse ligji dhe relacioni janë të njohur.

Faleminderit!

Arvid Uruçi – Faleminderit, zoti kryetar!

Ndryshimet kryesore të këtij projektligji kanë të bëjnë me përfshirjen e parimit automatik të mbrojtjes së dizenjës regjistruese, sipas ligjit “Për mbrojtjen e të drejtës së autorit”; reflektimin e kërkesave të traktatit të Budapestit, kërkesa që përmbledhin përcaktimin e rregullave për hartimin e përshkrimit të shpikjes në rastet kur përdoret një material që nuk është i disponueshëm nga publiku; përshkrimin e qëllimit për patentën joteknike; përfshirjen e kërkesave që kanë të bëjnë me licencimin e detyrueshëm në rastet kur varieteti i një bime nuk mund të shfrytëzohet pa shkelur një partet ekzistues dhe e kundërta.

Gjithashtu, në kuadër të anëtarësimit të Shqipërisë në Konventën Europiane të Patentave, u bë e nevojshme edhe ndryshimi i kreut për patentat e shtrira europiane. Për rrjedhojë u hartua një kre i ri për patentat europiane, të cilat bëhen të vlefshme në vendin tonë në mbështetje të kësaj konvente.

Ndryshimi kryesor është fshirja e parimit të mbrojtjes së një dizenjoje të paregjistruar, pasi mbrojtja e një dizenjoje të tillë nuk është e përcaktuar saktësisht në ligj, specifikisht për sa i përket kohëzgjatjes dhe qëllimit të së drejtës së dhënë. Fshihen disa nga rastet kur dizenjoja refuzohet për arsye relative, këtu përfshihet një listë e hapur e shenjave dalluese, që mund të regjistrohen si markë. Gjithashtu, për t’u përfruar me direktivën përkatëse të BE-së, si dhe konventën e Parisit, janë përcaktuar arsyet absolute dhe relative të refuzimit për regjistrimin e një marke. Po ashtu ndryshohen për qëllim përfrimin me direktivën edhe nenet që rregullojnë të

drejtat që vijnë nga regjistrimi i markës, kufizimet përkatëse, si dhe rastet e evokimit apo shfuqizimit të markave.

Hapen për herë të parë procedurat për regjistrimin e markës certifikuese dhe rregullohen procedurat e aplikimit për marka kolektive për regjistrimin dhe shfuqizimin e tyre, me synim harmonizimin me direktivën e vitit 2004/48 të KE-së, si dhe sistemimeve të mira të ligjit për rregullimin e ushtrimit të të drejtave që lindin nga patentat, markat, dizenjoja apo tregues gjeografik. Këto qëndrojnë si një kapitull vetëm në ligj. Nga zbatimi i ligjit në praktikë është parë i nevojshëm edhe ndryshimi i procedurave të ekzaminimit. Gjithashtu është përfshirë një listë e hapur e shenjave dalluese, që mund të regjistrohen si marka. Kjo është bërë për t'u përafuar me direktivën përkatëse të BE-së, si dhe me konventën e Parisit.

Janë bërë rregullime për ushtrimin e të drejtave që lindin nga patentat, markat, dizenjoja dhe treguesit gjeografik, të cilët janë përqendruar në një kapitull të vetëm në fund të ligjit.

Këto ishin ndryshimet kryesore që prekin këtë ligj. Ndryshimet e propozuara nuk kanë asnjë implikim financiar.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Fjalën e ka relatorja e komisionit.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Sikurse e tha edhe kryetari i Komisionit të Ligjeve, ne jemi komision për dhënie mendimi, pra do të shikojmë nëse projektligji që paraqitet në këtë komision për miratim është në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit në lidhje me mënyrën e paraqitjes dhe të trajtimit të tij.

Në fakt, ligji është shumë i gjerë dhe shumë i rëndësishëm. Ky ligj daton në vitin 2008. Aktualisht po bëhen disa ndryshime dhe shtesa, të cilat prekin një numër të konsiderueshëm dispozitash të këtij ligji. Kjo nismë është miratuar nga Departamenti e Markave dhe Patentave dhe e ka sjellë Këshilli i Ministrave.

Ky ligj është detyrim për t'u përditësuar dhe për t'u përshtatur, sepse është në kuadër edhe të MSA-së dhe të integritetit të përafrimit të legjislacionit me standardet e *acquis communautaire*.

Ky ligj, siç e thanë edhe prezantuesit, përafuron legjislacionin shqiptar me katër direktivat kryesore të BE-së. Unë nuk do të ndalem në përmbajtjen konkrete të ligjit dhe në risitë e tij,

sepse secili prej jush ka përpara relacionin e përgatitur nga unë, por te disa momente specifike, duke ruajtur edhe të drejtën për të bërë pyetje dhe sqarime gjatë shqyrtimit nen për nen.

Së pari, harmonizohet legjislacioni shqiptar me atë europian për mbrojtjen e dizenjoshë regjistruar në lidhje me procesin e refuzimit dhe të lëshimit të një patente, kur nuk duhet të refuzohet baza e një produkti. Pra, rregullohen problemet që lidhen me shpikjen, me të ashtuquajturën patentë bioteknike.

Së dyti, ka mbrojtje të veçantë të patentës, sipas kërkesave të Konventës Europiane të Patentave.

Në ligj shfuqizohen pesë kre, si dhe futet një kre i ri për të mbrojtur më mirë të drejtat e pronësisë industriale, duke përdorur një terminologji që është disi e veçantë dhe u përshtatet rregullave ose direktivave të BE-së.

Çështjet që dua të diskutoj, nëse më lejoni, zoti kryetar, dua t'i zhvillojmë gjatë shqyrtimit nen për nen, meqenëse ka çështje konkrete dhe nuk dua të ndalem në mënyrë të veçantë. Ky ligj është në përputhje me standardet e përcaktuara në direktivat e BE-së dhe me Kushtetutën. Pra, projekti i propozuar respekton Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Ky projektligj ka ardhur në komision sipas rregullave të përcaktuara në Rregulloren e Kuvendit.

Këto kisha në përgjithësi, sepse kam më shumë komente dhe pyetje për nenet specifike të këtij ligji.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Para se të fillojmë shqyrtimin, më duhet ta them në mënyrë të përsëritur se ne e kemi parë me kujdes projektin. Në mënyrë të përsëritur, projektet që vijnë nga ministria kanë probleme me përputhshmërinë, me kuadrin ligjor në fuqi dhe me praktikën. Gjithsesi, herë tjetër, nëse përfaqësimi do të jetë thjesht në këtë nivel, nuk do të pranoj që të vazhdojmë mbledhjen e komisionit. Sot, duke qenë se procesi është hapur, po vazhdojmë, por shpresoj që kjo gjë të mos përsëritet më. Kjo nuk është përgjegjësia juaj, por e titullarëve tuaj.

Kush është dakord me projektligjin në parim? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet projektligji në parim.

Kalojmë në shqyrtimin nen për nen.

Do të ndjekim linjën me të cilën kanë punuar relatorja dhe këshilltarët, sepse është bërë një punë goxha e vlerësueshme. Kështu që, nëse përfaqësuesit e ministrisë kanë ndonjë gjë për projektin dhe vërejtjet e paraqitura nga relatorja dhe stafi i komisionit, mund t'i thonë.

Besoj se e keni projektin e paraqitur, kështu që, ju lutem, na ndiqni!

Neni 1.

Vasilika Hysi – Në lidhje me nenin 1, për pikën 2 kam një pyetje dhe një propozim. Ju keni shtuar fjalinë: “Mbrotjtja e sipërpërmendur për dizenjot industriale nuk i përjashton të drejtat e tjera të parashikuara në ligj”. Përveç ligjit për të drejtën e autorit, a ka të drejta të tjera që mbrohen në ligje të tjera? Jo.

Unë sugjeroj që kjo shtesë që keni bërë është parazite dhe përsëritje e vazhdimit të paragrafit. Prandaj, a mund të heqim këtë shtesë? Fjalja në vazhdim a e plotëson paragrafin, sepse keni një përsëritje të mbrojtjes dhe citimit të të drejtave të autorit?

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

A keni vërejtje?

Arvid Uruçi – Jemi dakord.

Fatmir Xhafaj – Kush është dakord me nenin 1, me ndryshimin e propozuar? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2.

Vasilika Hysi – Unë kam konstatuar se nëpër tekst keni shumë përkufizime ose keni përdorur terma, të cilat nuk janë në pjesën e përkufizimeve. Do t'ju sugjeroja që çdo shkurtim të fjalëve që përdorni dhe çdo inicial duhet të jetë te neni 4, i cili bën fjalë për përkufizimet. Pra, keni shumë përkufizime në ligj, që nuk dihen se çfarë do të thonë.

Ju lutem, shikoni edhe propozimin për nenin 87/1, te germat “a dhe b” e “c dhe ç”, sepse keni përkufizime. A ekziston mundësia për ta kaluar te ky kre, apo do t'i lini tek ajo pjesa që ju i keni parashikuar?

Fatmir Xhafaj – Dakord?

Arvid Uruçi – Jemi dakord me vërejtjen tuaj.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Kush është dakord me nenin 2, me vërejtjet e relatores? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 3.

Vasilika Hysi – Në lidhje me këtë nen, unë mendoj se propozimi i sjellë duhet të riformulohet, sepse është i paqartë. Unë jam përpjekur të bëj një riformulim, ai ndodhet në kolonën e tretë, ju lutem, shikojeni dhe na thoni nëse jeni dakord.

Unë mendoj se riformulimi i fjalisë së dytë, të pikës 1 në nenin 6 të jetë: “Shfrytëzimi nuk konsiderohet se bie ndesh me moralin ose rendin publik vetëm për shkak se ai ndalohet me ligj ose akte nënligjore, përveçse kur cenon një normë urdhëruese”. Janë shtuar fjalët “...nëse cenon një normë urdhëruese”, sepse nga mënyra sesi e keni vënë fjalinë, nuk është në strukturën e gjuhës shqipe, duhet të jetë e përkthyer.

Arvid Uruçi – Jemi dakord me propozimin tuaj.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Kush është dakord me nenin 3, me ndryshimin? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 4.

Vasilika Hysi – Unë jam dakord me këtë nen.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Kush është dakord me nenin 4? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 5.

Vasilika Hysi – Në fakt, ju keni shtuar fjalën “dukshëm”, por unë mendoj se kjo është shumë subjektive. Prandaj mendojmë se duhet ta riformulojmë, sepse nga mënyra sesi e keni sjellë lë shteg për abuzim.

Lindita Mëneri – Ne mund ta riformulojmë, por, duke pasur parasysh se të gjitha këto janë bërë në përshtatje me direktivat, mendojmë se do të ishte mirë që t’i rishikonin, sepse më pas mund të na thonë se nuk i kemi përshtatur. Ndryshimi është bërë vetëm për të shtuar këto dy fjalë dhe për të bërë këtë përshtatje. Ato janë pak të vështira për t’u përkthyer.

Rudina Bollano – Ky përkufizim është në përputhje me përkufizimin që i bën Konventa Europiane e Patentave një shpikjeje.

Lindita Mëneri – Të gjitha këto ndryshime janë bërë nga Zyra Europiane e Patentave.

Vasilika Hysi – Po të shikoni riformulimin, unë nuk e kam hequr pjesën e dukshme, por kam thënë: “Të jetë e kuptueshme për nivelin e njohurive të një personi të kualifikuar”, sepse

nuk është shqip. Më vjen keq që e them, me gjithë respektin që kam për Europën, por ne kemi terminologjinë shqiptare dhe fjalorin tonë në gjuhën shqipe.

Fatmir Xhafaj – Kush është dakord me nenin 5, me vërejtjet e relatores? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 6.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, te ky nen është po ajo që keni thënë ju, veçse e kam kthyer fjalinë në drejtshkrimin e gjuhës shqipe: kryefjalë, kallëzues dhe kundrinë.

Fatmir Xhafaj – Me pak fjalë, ua kanë përkthyer dhe siç e kanë përkthyer nga anglishtja e keni vendosur aty pa e shqipëruar. Neni 6 është shqipëruar sipas gjuhës shqipe.

A jeni dakord me nenin 6.

Arvid Uruçi – Dakord!

Fatmir Xhafaj – Kush është dakord me nenin 6? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 7.

Vasilika Hysi – Jam dakord me këtë nen.

Fatmir Xhafaj – Kush është dakord me nenin 7? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 8.

Vasilika Hysi – Unë kam një sugjerim. Besoj se edhe në Konventën Europiane të Patentave, kur një person aplikon për regjistrim, nëse ka mungesë në dokumentacion, ai duhet të njoftohet për ta plotësuar këtë dokumentacion dhe i lihet një afat. A mund të parashikohet mundësia që t'i lihet afat? Çfarë do të bëhet nëse refuzon për të plotësuar dokumentet dhe nuk i plotëson ato në afatin e duhur? Nëse i plotëson në një afat tjetër, cila do të quhet dita e regjistrimit të markës ose patentës?

Rudina Bollano – Ky nen është në përputhje me Konventën Europiane të Patentave. Zyra jonë në bazë të ligjit e fton aplikantin për të bërë plotësimet e duhura në kërkesën për patentë. Nëse dokumentacioni nuk plotësohet, atëherë humbet edhe data e depozitimit, por në të njëjtën kohë humbet edhe risia për një patentë.

Fatmir Xhafaj – Kush është dakord me nenin 8? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet kështu siç është.

Neni 9.

Vasilika Hysi – Jemi dakord me këtë nen.

Fatmir Xhafaj – Kush është dakord me nenin 9? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 10.

Vasilika Hysi – Te neni 10, te fjalia e fundit e pikës 7 kemi bërë një riformulim, sepse ju thoni: “Aplikanti paguan tarifën e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave të nxjerrë në zbatim të ligjit. Në të kundërt kërkesa refuzohet”. Kjo nuk është shqip, prandaj sugjeroj: “Kërkesa refuzohet nëse aplikanti nuk paguan tarifën e përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave të nxjerrë në zbatim të këtij ligji”. A jeni dakord? Në rregull.

Fatmir Xhafaj – Kush është dakord me nenin 10? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 11.

Vasilika Hysi – Jam dakord.

Fatmir Xhafaj – Kush është dakord me nenin 11? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 12.

Vasilika Hysi – Në këtë nen është vërejtja që përmenda më lart.

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

Kush është dakord me nenin 12, me sugjerimin e relatores? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 13.

Vasilika Hysi – Ky nen ka të bëjë me riformulimin, por, ju lutem, shikojeni, sepse, nëse do të lemë fjalën në latinisht, sugjerimi është që në nenin 4, i cili bën fjalë për përkufizimet, të jepni kuptimin e fjalëve në latinisht. Nëse do të përdorim fjalët në latinisht, nuk kemi pse të përdorim shqipen në kllapa ose anasjelltas. Ju përdorni dy sinonime për të njëjtën fjalë.

Po e përsëris, sepse keni shumë fjalë në latinisht, nëse do t'i lemë këto fjalë, te kreu 4, i cili bën fjalë për përkufizimet, jepni edhe përkufizimin.

Fatmir Xhafaj – Ky është një element bazë që nuk duhet pranuar. Një ligj duhet të ketë terminologji të pranuar dhe duhet të jetë lehtësisht i kuptueshëm. Kjo është A-ja në procesin e hartimit të një ligji.

A jeni dakord me vërejtjet e bëra?

Arvid Uruçi –Dakord.

Fatmir Xhafaj - Kush është dakord me nenin 13, me vërejtjet e relatores? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 14, me sugjerimin që është bërë për riformulim?

Vasilika Hysi – Unë nuk jam kundër këtij neni, por ju lutem shqipërojeni, pa ndryshuar thelbin.

Fatmir Xhafaj – A jeni dakord me nenin 14, me sugjerimin e relatores?

Arvid Uruçi – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Kush është dakord me nenin 14, me sugjerimin e relatores? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 15.

Kush është dakord me nenin 15? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 16?

Vasilika Hysi – Në këtë nen ju thoni: “Gjykata”. Pse keni lënë Gjykatën e Tiranës? Ky ligj nuk mund ta përcaktojë se cila është gjykata kompetente. Përcaktimi i gjykatës kompetente bëhet nga ligji “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor”. Ky është një ligj që kalon me shumicë të thjeshtë. Ndërsa kompetencat e gjykatave përcaktohen në ligjet e cilësuar.

Lindita Mëneri – Për çështjet e pronësisë industriale merret vetëm Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Prandaj është përcaktuar Gjykata e Tiranës. Për shembull, nëse ka një çështje në Korçë, ajo nuk shqyrtohet atje, por vjen për t’u shqyrtuar në Tiranë. Pavarësisht se konflikti mund të jetë në gjykatën e Korçës, por çështja shqyrtohet në gjykatën e Tiranës.

Vasilika Hysi – Meqenëse kjo është një praktikë, ne po e lemë të hapur, që të jetë në përputhje edhe me ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor” dhe me Kodin e Procedurës Civile, i cili ka prioritet mbi ligjin tuaj.

Fatmir Xhafaj – A jeni dakord me sugjerimin e relatores?

Vasilika Hysi – Në pjesën e fundit të fjalisë jeni kontradiktorë në lidhje me patransportueshmërinë në rastet kur transferohet patentat e dytë. Ju lutem, shiheni formulimin me

qetësi, sepse atë çka jepni më lart e kundërshtoni në një paragraf më poshtë. Unë sugjeroj që formulimi të jetë i qartë, të mos jetë evaziv dhe të ketë kuptime në të dyja variantet.

Fatmir Xhafaj - Kush është dakord me nenin 16, me sugjerimin e relatores? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 17.

Kush është dakord me nenin 17? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 18.

Vasilika Hysi – Ky nen nuk është i qartë, prandaj, ju lutem, saktësojeni! Unë kam bërë një formulim të nenit, nuk e di nëse jeni dakord: “Efekti i heqjes dorë nga patentat fillon nga data e regjistrimit të kërkesës në regjistrin e patentave”, sepse keni thënë: “Regjistri i patentave zëvendësohet me kërkesë”. Nuk bën sens propozimi juaj. Nuk e di nëse e kam përkthyer qartë.

Fatmir Xhafaj – A jeni dakord me sugjerimin e relatores?

Arvid Uruçi – Dakord.

Fatmir Xhafaj - Kush është dakord me nenin 18? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 19.

Fatmir Xhafaj – Kush është dakord me nenin 19? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 20.

Vasilika Hysi – Këtë dua ta mendojnë me qetësi, a do t’i lënë përkufizimet këtu, apo do t’i nxirrni në kreun e përkufizimeve? Por gjithmonë duke ruajtur të drejtën që shkurtimet e fjalëve të jenë te pjesa e përkufizimeve.

Fatmir Xhafaj – Kështu ka qenë në ligjin bazë.

A jeni dakord me sugjerimin? Dakord.

Miratohet neni 20.

Neni 21.

Kush është dakord me nenin 21? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 22.

Vasilika Hysi – A është e mundur ta saktësojmë kohën sa më parë, të lëmë ndonjë afat? Pra, ju keni shtuar dhe është e drejtë që të bëhet pagesa sa më shpejt. Por a mund të lëmë një afat.

Fatmir Xhafaj – Është subjektive ajo dhe më pas subjektivizmi çon në logjika të tjera. Kjo është logjika.

Rudina Bollano – Është identike siç është në Konventën Europiane të Patentave.

Fatmir Xhafaj – Ajo është direktivë, ndërsa ligji nuk është direktivë. direktiva është orientuese.

Miratohet neni 22.

Neni 23.

Kush është dakord me nenin 23? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 24.

Kush është dakord me nenin 24? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 25.

Vasilika Hysi – Ju keni fshirë një kre dhe keni shtuar një nen ku thoni: “Dispozitat e Konventës Europiane të Patentave dhe të Rregulloreve në zbatim të saj nuk zbatohen në lidhje me kreun 8”. Pse nuk kemi detyrim, ndërkohë që ne kemi patentat e shtrira europiane dhe patentat europiane?

Rudina Bollano – Aktualisht në vendin tonë në vitin 1996 ne kemi pasur një marrëveshje me Zyrën Europiane të Patentave. Në bazë të kësaj marrëveshjeje, këto patenta ne i quajmë patenta që kërkojnë shtrirje në territorin e Shqipërisë. Këto patenta vazhdojnë ende të vijnë, pasi deri në vitin 2010 ka qenë në fuqi vetëm marrëveshja e shtrirjes. Nga viti 2010 edhe 20 vjet më pas, pasi 20 vjet është jetëgjatësia e patentës, ne nuk mund ta heqim këtë kre, sepse ende vazhdojnë dhe vijnë patenta në bazë të marrëveshjes së shtrirjes. Kreu i ri u fut, pasi patentat pas datës 1 maj të vitit 2010, kohë në të cilën ne jemi bërë vend anëtar i Zyrës Europiane të Patentave, nuk trajtohen më si patenta që shtrihen në vendin tonë, por si patenta të cilat kërkojnë vlefshmëri në bazë të kësaj konvente. Prandaj u detyruam të futnim edhe një kre të dytë, domethënë krahas kreut ekzistues që ishte, dhe e ndryshuam pak formulimin.

(Zonja Hysi ndërhyr pa mikrofon.)

Pasi nuk ka qenë në fuqi para vitit 2010, ndërsa tani jemi të detyruar. Domethënë, aktualisht në vendin tonë vijjnë patenta në bazë të marrëveshjes së shtrirjes dhe patenta që kërkojnë vlefshmëri në bazë Konventës Europiane të Patentave.

Vasilika Hysi – Unë jam shumë dakord me sqarimin tuaj dhe është i drejtë, por ju thoni se dispozitat e Konventës Europiane të Patentave dhe të Rregulloreve nuk zbatohen në lidhje me kreun 8, përveçse kur përcaktohet ndryshe. Përse të mos themi: “dispozitat zbatohen”, në vend të: “nuk zbatohen”?

Rudina Bollano – Nuk zbatohen pasi ka qenë marrëveshja e shtrirjes. Ato vijjnë në bazë të marrëveshjes së shtrirjes në Shqipëri. Në bazë të Konventës Evropiane të Patentave, janë patentat që vijjnë pas datës 1 maj, dhe i referohen Kapitullit 8/a.

(Ndërhyrje pa mikrofoni)

Po.

Fatmir Xhafaj – Ok, vazhdojmë me nenin 25.

Lida, saktësojeni para se ta çoni propozimin e zonjës Hysi!

Ka ndonjë sugjerim?

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 26, me vërejtjet e bëra për riformulimin e neneve 87 etj.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet me vërejtjen e bërë nga relatorja.

Vasilika Hysi – Kam një pyetje dhe një sugjerim. Ky nen i projektligjit ka disa nene. Ju a do të bëni rregullore?

Nëse do të bëhet një rregullore, a është e mundur që kur të riformuloni këto nene për t'i bërë më koncize, dhe pjesët që janë për rregulloren, t'i lini të rregullorja dhe të mos shpjegoni në detaje elementët që janë për rregulloren. Në parim jam dakord me të gjithë elementët që keni futur, por nuk mund të zgjatet një nen 7-8 faqe. Një nen që zgjat 6,5 faqe për mendimin tim është shumë. Nuk jam kundër përmbajtjes së neneve.

Fatmir Xhafaj – Jeni dakord me nenin 26, me reflektimin e bërë? Përfaqësuesit e ministrisë, a janë dakord?

Arvid Uruçi – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Neni 27. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 28. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 29. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 30, me vërejtjen e bërë.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet me vërejtjen e bërë nga relatorja. Përfaqësuesit e ministrisë janë dakord?

Rudina Bollano – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Neni 31. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 32. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet, sipas variantit të ministrisë.

Neni 33.

Vasilika Hysi – Kam një pyetje: te neni 33, ju keni hequr pikat “d” dhe “dh”, pra, ju thoni që refuzimi për shkaqe relative i pamjeve të njerëzve, hiqet. Unë dua të di se përse i mohohet e drejta një personi që të heqë nga dizenjot, fytyrën e tij? Përse e detyroni të ndryshojë këto shenjat e tjera?

Lindita Mëneri – Ndryshimet te dizenjot për bazat absolute dhe relative, nuk janë bërë nga zyra, por janë bërë nga ...

Ne e kemi detajuar më parë ligjin, për të futur edhe këto, për ta bërë sa më të qartë dhe për t'i dhënë mundësi për ta kufizuar, për ta përshtatur edhe me bazat absolute të ligjeve.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Miratohet, me vërejtjen e bërë nga komisioni përgjegjës.

Neni 34.

Vasilika Hysi – Jeni dakord me sugjerimin për ta riparë?

Lindita Mëneri – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Miratohet.

Neni 35. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 36. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 37. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 38. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 39. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 40, me riformulimin e bërë.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet me riformulimin e bërë. Përfaqësuesit e ministrisë janë dakord?

Lindita Mëneri – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Neni 41.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 42.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 43.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 44, me vërejtjen e bërë.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet me vërejtjen e bërë. Përfaqësuesit e ministrisë janë dakord?

Lindita Mëneri – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Neni 45.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 46.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 47.

Kush është dakord me propozimin e sjellë? Kundër? Abstenim?

Miratohet me propozimin e bërë.

Neni 48.

Kush është dakord me propozimin e sjellë? Kundër? Abstenim?

Miratohet me propozimin e bërë.

Neni 49.

Kush është dakord me propozimin për riformulim? Kundër? Abstenim?

Miratohet me propozimin e bërë për riformulim.

Lindita Mëneri – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Neni 50.

Kush është dakord me propozimin për riformulim? Kundër? Abstenim?

Miratohet me propozimin e bërë për riformulim.

Lindita Mëneri – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Neni 51.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 52.

Kush është dakord me riformulimin e propozuar? Kundër? Abstenim?

Lindita Mëneri – Dakord, do ta shikojmë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Miratohet neni 52 me riformulimin e bërë.

Neni 53.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Lindita Mëneri – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Neni 54.

Kush është dakord me propozimin për riformulim të këtij neni?

Kundër? Abstenim?

Miratohet me propozimin e bërë për riformulim.

Lindita Mëneri – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Neni 55.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Fatmir Xhafaj – Neni 56.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet, sipas variantit të ministrisë.

Neni 57.

Kush është dakord me propozimin për riformulim të këtij neni? Kundër? Abstenim?

Lindita Mëneri – Do ta shikojmë. Nenet janë kaq të gjata, sepse kemi zbatuar direktivën. Më kuptoni? Kjo është vështirësia.

Fatmir Xhafaj – Zonjë, po ta sqaroj që të mos e thuash më: midis direktivës dhe ligjit ka ndryshim thelbësor; direktiva mund të jetë edhe 2 faqe, kurse ligji, norma, s'mund të jetë dy faqe.

Vasilika Hysi – Sugjerimi ynë është që këtë përmbajtje ta ndani nëpër nene, grupoheni nëpër nene! Nuk ju thotë njeri ta hiqni direktivën, por s'mund të ketë një nen kaq të gjatë.

Fatmir Xhafaj – Neni 58.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 59.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 60.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 61, s'ka vërejtje apo sugjerime.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 62.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 63.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 64, me sugjerimin për rishikim të terminologjisë dhe shkrimit ligjor.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Lindita Mëneri – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Miratohet neni 64, me sugjerimin e bërë.

Neni 65.

Vasilika Hysi – Neni 65 është riformuluar dhe ka nevojë të rregullohet, sipas Kodit të Procedurës Civile. Në relacionin që unë kam paraqitur, kam kërkuar një riformulim të kësaj dispozite dhe konkretisht, të dëmit efektiv real përfshirë dhe fitimin e munguar, që ka pësuar pala e dëmtuar, e me radhë. Nëse doni, zoti kryetar, unë mund t'ua vë në dispozicion.

Fatmir Xhafaj – E ka. Jeni dakord me propozimin?

Vasilika Hysi – Ju lutem shikojeni, që të jetë në përputhje me Kodin Civil.

Fatmir Xhafaj – Këtu ne nuk tolerojmë, sepse ka të bëjë me përputhshmërinë me Kodin Civil. Jeni dakord?

Arvid Uruçi - Jemi dakord.

Fatmir Xhafaj – Neni 66.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet me sugjerimin e bërë.

Neni 67.

Kush është dakord me sugjerimin e bërë?

Vasilika Hysi – Ju lutem, zoti kryetar!

Nenin 67 duhet ta diskutojmë, sepse duhet të shohim përputhshmërinë e këtij neni me Kodin e Procedurës Civile, lidhur me kompetencat e gjykatës për të bërë kontroll, lidhur me të drejtën e përmbaruesit për të hyrë dhe për të bërë kontroll, si dhe lidhur me marrjen e masave

të përkohshme, kur personi ngre një padi në gjykatë. Duhet të ulemi ta diskutojmë, të konsultohemi, sepse duhet të jetë në përputhje me Kodin e Procedurës Civile.

Fatmir Xhafaj – Më duket i arsyeshëm propozimi i bërë, sepse këto 3 nene duhet t'i risaktësojmë dhe t'ia dërgojmë komisionit përgjegjës. Jeni dakord?

Lindita Mëneri – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Nenet 67, 68 dhe 69 kalojnë me vërejtjen dhe sugjerimin e bërë.

Neni 70. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet sipas propozimit të sjellë.

Neni 71. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 72. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 73, me një ndryshim që duhet t'i propozohet komisionit: hyrja në fuqi të mos jetë 15 ditë, sepse duhet t'u bëhet e njohur kompanive.

Vasilika Hysi – Unë pajtohem me shqetësimin dhe sugjerimin tuaj, por unë do të doja që propozuesit të shikojnë edhe një herë aktet nënligjore, për të saktësuar nëse i keni nxjerrë të gjitha dispozitat, ku duhet të dalin aktet nënligjore. Mua më rezultojnë, sikur janë më shumë nene se sa janë cituar.

Lidhur me rregullin e ri që është vendosur, për miratimin e ligjeve që duhet të jenë në përputhje me direktivat, stafi i Komisionit të Ligjeve, këshilltarët sugjerojnë që ky ligj është i përafëruar sipas direktivave dhe kjo të shënohet në fund të faqes, duke listuar të gjitha direktivat e BE-së, sipas vendndodhjes së tyre në Fletoren Zyrtare të BE-së. Ne kemi propozuar të jetë në praktikën e Kuvendit, që për çdo ligj që është në përputhje me direktivat e BE-së, të shënohet në *footnote*, që ky ligj është në përputhje me direktivën me numër ...

Fatmir Xhafaj – Dakord. Janë dakord specialistët?

Arvid Uruçi – Dakord.

Lindita Mëneri – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Do t'ju lutesha që para se ta votojmë në tërësi, duke respektuar gjithë këtë punë që kemi bërë, në përshtatje të direktivës, e cila nuk është një direktivë e lehtë, i gjithë grupi i këtyre direktivave janë nocione të reja për ne dhe në mënyrë të veçantë, për biznesin dhe

duhet të jemi shumë të kujdesshëm dhe prandaj duhet të na mirëkuptoni se përse insistojmë me riformulim në qartësinë e dispozitës. Do t'ju lutesha të punonit së bashku me stafin tonë në zbardhjen që do t'i bëni, për t'i riparë me kujdes dhe për t'ia kaluar komisionit përgjegjës, i cili do të vendosë për variantin që do t'i paraqitet seancës.

Na mirëkuptoni, janë direktiva të vështira. Ne nuk kemi as traditë dhe as përvojë në vendin tonë. Kur janë të vështira për ne dhe për ju ekspertët, janë akoma më të vështira për biznesin. Detyra jonë është që t'ua bëjmë ligjet të kuptueshme dhe të qarta, që të jenë të zbatueshme, për efekt të nevojës që kemi për t'u zbatuar ligjet nga subjektet e përfshira. Jeni dakord?

Atëherë, kush është dakord në tërësi me ndryshimet e bëra? Kundër? Abstenim?

Miratohe.

Faleminderit! Faleminderit për kontributin, zonja Bollano, zonja Meri, zoti Uruçi! Shpresojmë që të kemi mundësi herë tjetër, t'i reflektoni më mirë sugjerimet.

Do t'iu lutesha të punonit mbas mbledhjes, me relatorin dhe me stafin për të vazhduar përgatitjen e raportit që do t'i dorëzohet komisionit përgjegjës.

Faleminderit! Vlerësim për punën tuaj si ekspertë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 14.05.2014, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9572, datë 3.7.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Blendi Klosi, Bashkim Fino, Ermonela Felaj, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Mark Frroku, Petrit Vasili, Dashamir Peza, Armando Prenga, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Piro Lutaj, Vexhi Muçmataj, Spartak Braho dhe Silva Caka.

Mungojnë:

Keltis Kruja, Tahir Muhedini, Edi Paloka, Kastriot Islami, Oerd Bylykbashi, Fatmir Mediu, Tom Doshi, Gjovalin Bzheta, Nard Ndoka, Arben Ristani, Eduard Halimi, Mhill Fufi dhe Gent Strazimiri.

Të ftuar:

Ervin Mete - zëvendësministër i Financave

Lindita Rusmali - drejtoreshë e legjislacionit në Ministrinë e Financave.

Teuta Baleta – përfaqësuese e AMF-së

Gladiola Hysi – përfaqësuese e AMF-së

Fatmir Xhafaj – Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës. Për shkak të një ngarkese të relatores, pikën e tretë të rendit të ditës do ta kalojmë si pikë të dytë. Kemi relatimin për dekretet.

Spartak Braho – Për procedurë, meqenëse ne nuk jemi njohur paraprakisht me relacionin (them ne, duke pasur parasysh kolegët Vasili dhe Caka), kërkojmë që të shtyhet shqyrtimi i dekretit.

Fatmir Xhafaj – Për kur të shtyhet?

Spartak Braho – Në mbledhjen e parë më të afërt, në mënyrë që të njihemi me relacionin.

Fatmir Xhafaj – Relacionin do ta lexojë relatorja. Pastaj mund ta vlerësoni. Kjo pikë është futur në rendin e ditës. Javën që vjen është e vështirë.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Dakord. Kjo pikë ishte në rendin e ditës. Mund ta kishit thënë që kur u bë kalendari. Relacionin mund ta kishe marrë te kutia.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Nuk jam dakord me këtë praktikë, sepse nuk është praktikë e shëndetshme. E them publikisht që nuk është praktikë e shëndetshme, po të keni vërejtje dhe sugjerime mund t'i bëni që më parë.

Spartak Braho – Duhet të kemi paraprakisht relacionin që të përgatitemi.

Fatmir Xhafaj – Prandaj është relatorja, që ta lexojë dhe të njiheni me të.

Spartak Braho – Tani erdhi relacioni. Asnjë anëtar i komisionit nuk e ka relacionin.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës, meqë zoti Braho nuk ka lexuar relacionin.

Shqyrtimin e kësaj pike të rendit të ditës do ta shtyjme për sot pasdite, në orën 17:00, meqë s'është lexuar materiali.

Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës me projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9572, datë 03.07.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”. E kemi miratuar në parim dhe do të vazhdojmë shqyrtimin nen për nen.

Fillojmë me nenin 1. Fjalën e ka relatorja!

Ermonela Felaj – Në nenin 1, propozojmë ndryshimin si vijon:

Pika 1 riformulohet:

“Autoriteti është person juridik publik, i cili është i pavarur në ushtrimin e kompetencave, sipas legjislacionit në fuqi.”

Sugjerojmë të hiqet pika 2, në projektligjin e propozuar.

Teuta Baleta - Atëherë, siç jemi shprehur edhe në relacionin shtesë, ne jemi dakord në parim me arsyetimin e komisionit. I vetmi problem është që në praktikën e punës kjo pavarësi nuk është respektuar, prandaj, siç sugjerohet nga literatura, e kemi parë edhe në legjislacione të tjera dhe ju kemi dhënë një shembull konkret që është rasti i Kroacisë, është e nevojshme që ligji ta përforcojë në formë deklarative këtë.

Gjithashtu, kemi ofruar edhe një riformulim në relacionin shtesë dhe do të kërkonim që ai të mbetet në fuqi.

Fatmir Xhafaj – Gjithsesi, riformulimi që është bërë mund të ketë vend që ta rishikoni përsëri, por ne biem dakord në parim me nenin 1.

Neni 2.

Ermonela Felaj – Pas nenit 1, sugjerojmë të shtohet neni 2, me përmbajtje si vijon:

“Në nenin 4, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Organet e Autoritetit janë Bordi dhe drejtori i Përgjithshëm.

Bordi i Autoritetit ushtron kompetenca me natyrë vendimmarrëse dhe përbëhet nga një kryetar, një nënkryetar dhe tre anëtarë të tjerë.

Drejtori i Përgjithshëm ushtron kompetenca me natyrë ekzekutive. Ai organizon dhe mbikëqyr veprimtarinë e dy drejtorive që mbulojnë tregjet, për të cilat Autoriteti është përgjegjës.

Teuta Baleta – Në lidhje me këtë riformulim të nenit, kërkojmë kohë për shqyrtim, sepse përbën një ndryshim thelbësor.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Jeni dakord me nenin 2 të projektligjit?

“Në nenin 5 bëhen këto ndryshime:

1. Në paragrafin e parë, të pikës 3, fjalët “... me përvojë të paktën 3-vjeçare ...” zëvendësohen me “... me përvojë profesionale të paktën 10-vjeçare, nga e cila, të paktën, 5 vjet ...”.

Teuta Baleta – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Ne jemi dakord në parim me nenin 3, por të lidhet edhe me sugjerimin e mëparshëm.

Jeni dakord?

Teuta Baleta – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Miratohet neni 3.

Neni 4.

Ermonela Felaj – Propozoj që neni 4 të ndryshohet, si vijon:

“Anëtarët e Bordit të AMF-së mund të rizgjidhen për një mandat të dytë, pas përfundimit të mandatit të tyre”. (Mund dhe ta përfundojmë fjalinë: mund të rizgjidhen për një mandat të dytë”, se kuptohet kur zgjidhen).

Kryetari dhe nënkryetari i Bordit të AMF-së, pas përfundimit të mandatit, nuk mund të rizgjidhen rishtas për të njëjtin mandat.

Fatmir Xhafaj – Urdhëroni!

Teuta Baleta – Edhe për këtë kërkojmë kohë ta shqyrtojmë, sepse lidhet me nenin që rishikon strukturat e Autoritetit.

Fatmir Xhafaj – Neni 5.

Ermonela Felaj – Për nenin 5 ne kemi parashtruar dy alternativa: e para, mund ta pranojmë si propozim, duke qenë se Banka Botërore ka rekomanduar kalimin e ndryshimeve në ligjin për AMF-në, të cilat do ta fuqizonin Autoritetin për t’i ofruar kushte konkurruese pagese stafit teknik për të mundësuar tërheqjen e profesionistëve të kualifikuar të tregut të sigurimeve. Duke pasur parasysh që me ndryshimet e propozuara në nenin 26 të ligjit të AMF-së parashikohet që Autoriteti është një institucion i pavarur financiarisht, pra financohet nga burimet e veta, hiqet parashikimi ligjor për mbulimin nga buxheti i shtetit. Pra, parimisht ky propozim nuk do të ketë kosto negative në buxhetin e shtetit. Alternativa tjetër është se mund të pranohet vetëm propozimi për përcaktimin e strukturës organizative nga vetë bordi, duke pasur parasysh praktikën e mëparshme jopozitive për sa i takon krijimit të privilegjeve dhe trajtimeve të tjera preferenciale të tepruara të stafit, si dhe të precedentëve që mund të krijohen në të ardhmen në efektin zinxhir nga entet e tjera rregullatore, të cilat në ligjet ekzistuese ia kanë lënë këtë atribut Kuvendit. Pra, na thoni nëse jeni dakord me alternativën e parë, apo me të dytën?

Teuta Baleta – Ne jemi dakord me alternativën e parë. Gjithsesi, e theksoj edhe një herë, meqenëse ka një propozim për ndryshim strukture të drejtuesit të bordit, kjo do të shikohet edhe në këtë raport, me qëllim që të ruajmë një raport optimal pavarësi-përgjegjshmëri.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 6.

Ermonela Felaj – Edhe për nenin 6 kemi dy alternativa. E para, në rast se pranohet propozimi për strukturën e organizimit me dy nivele, është i nevojshëm propozimi i ndryshimeve përkatëse në këtë nen.

Alternativa e dytë, në rast se nuk pranohet propozimi për strukturën e organizimit me dy nivele, sugjerohen ndryshimet:

Në pikën 4 të themi: “Miraton, refuzon, pezullon apo heq licencat apo autorizimet për ushtrimin e veprimtarisë së subjekteve në tregjet financiare që mbikëqyren”. Sugjerojmë që pjesa tjetër e fjalisë të hiqet, se kështu siç është ndërtuar, na duket e pakuptimtë.

Pika 11: në rast se nuk pranohen propozime për ndryshime në nenin 9, të hiqet automatikisht edhe kjo pikë.

Pika 13: të përcaktohet në një referencë ligjore për sa i takon mënyrës së përlllogaritjes së tarifave, me qëllim shmangien e tarifave të larta dhe abuzive.

Pika 14: në rast se nuk pranohen propozimet për heqjen e fondit rezervë nga buxheti i shtetit dhe krijimin e fondit rezervë me vetëfinancimin e AMF-së, bie automatikisht edhe kjo pikë.

Pika 16 ka nevojë të qartësohet nga ju, pasi neni 17, paragrafi i fundit, parashikon që Kuvendi vendos, nëse është e nevojshme, caktimin e auditit të jashtëm të Autoritetit. Pyetja që na lind neve është: audit i caktuar nga Kuvendi është parashikuar të jetë i ndryshëm nga shoqëria audituese që do të miratonte vetë bordi?

Në rast se pranohet struktura e organizmit me dy nivele (në fakt, ju e dhatë përgjigjen tuaj për këtë gjë), pika 21 mund të formulohet: “Vendos me propozim të drejtorit të Përgjithshëm për masat e mbikëqyrjes dhe sanksionet ndaj subjekteve të mbikëqyrura, për të krijuar fleksibilitet dhe shpejtësi në procesin vendimmarrës”. Pas paragrafit të fundit sugjerojmë të shtohet edhe ky paragraf me këtë përmbajtje: “Vendimet e bordit me karakter individual u njoftohen subjekteve të interesuara brenda një afati të arsyeshëm”.

Faleminderit!

Teuta Baleta – Në lidhje me këto propozime, është grupi i parë, gjithsesi do të kërkohet kohë të ridiskutohen në bazë të asaj që do të vendoset për strukturat drejtuese.

Grupin e dytë po e marr një për një. Pra, është pika 4 me heqjen e pjesës që ju keni propozuar, në parim jemi dakord, por ne thjesht kemi parasysh që, përveç ligjit të AMF-së për mbikëqyrjen, janë edhe një sërë ligjesh të tjera të fushës: “Për mbikëqyrjen e sigurimeve”, “Për tregun e letrave me vlerë”, “Për titujt” etj., të cilat përcaktojnë gjithashtu kompetenca për AMF-në në lidhje me mbikëqyrjen e këtyre tregjeve, licencimin, miratimet e ndryshme etj. Është lënë ky formulim për të qenë gjithëpërfshirës.

Në lidhje me pikën 13 që të përcaktohet referenca ligjore, ne mendojmë se kjo e fundit është dhënë te nenet 26 dhe 27 të riformuluara të ligjit të AMF-së, ku jepet jo vetëm niveli maksimal i përcaktimit të tarifës, që do të paguhet nga ana e subjekteve të mbikëqyrura, por edhe llojet e tarifave, si edhe treguesi bazë mbi të cilin llogaritet kjo tarifë, pra që është 1,5 mbi një tregues të caktuar që përcakton ligji. Nuk lihet e hapur. Përveç kësaj, është parashikuar edhe një kompetencë e bordit që të sqarojë me detaje kriteret e përcaktimit të nivelit të tarifës, ku rakordohet si paguhet etj., me qëllim që gjithçka të jetë transparente me industrinë. Në përfundim tepricat i kthehen përsëri industrisë. Pra, këto para nuk i shkojnë një tjetër autoriteti.

Në lidhje me pikën 16, ku thuhet: “Kuvendi vendos nëse është i nevojshëm, caktimi i auditivit të jashtëm”, ky përcaktim ka qenë për sa kohë që bordi nuk kishte detyrimin të përcaktonte auditim të jashtëm. Ne nuk e kemi hequr, sepse auditimi i jashtëm mund të jetë edhe për qëllime specifike për të cilat bordi ka interes të dijë nëse veprimtaria e Autoritetit është në përputhje ose jo me ligjin, pasi forcon në fund elementet e përgjegjshmërisë.

Fatmir Xhafaj – Jemi dakord më çfarë u diskutua për nenin 6.

Miratohet.

Neni 7 bashkë me sugjerimet që janë bërë. Besoj se i keni përpara.

Ermonela Felaj – Në lidhje me nenin 7 të projektit, propozohen përsëri dy alternativa. Në rast se pranohet propozimi për strukturën e organizmit me dy nivele, është i nevojshëm propozimi i ndryshimeve përkatëse në këtë nen.

Në fakt, ju e thatë gjatë fjalës suaj se nuk ishit dakord me këtë propozim.

Alternativa e dytë, në rast se nuk pranohet propozimi për këtë strukturë, është që të sugjerohen ndryshime në pikat e mëposhtme:

Të lihet pjesa e hyrjes në nenin 15 të ligjit ekzistues, që parashikon: “Kryetari i bordit organizon dhe administron veprimtarinë e autoritetit dhe të administratës së tij, me përjashtim të veprimtarive që janë në kompetencë të nënkryetarëve apo anëtarëve të tjerë të bordit, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi”.

Pika 3 e nenit të propozuar sugjerohet të mos ndryshojë dhe të jetë njësoj me pikën 5 të ligjit ekzistues.

Pika 6 të formulohet si vijon: “I propozon bordit çështjet që janë të nevojshme për mbarëvajtjen e veprimtarisë së AMF-së”.

Pika 8 të ndryshohet si vijon: “Nxjerr urdhra dhe udhëzime për të përmbushur kompetencat e tij me karakter ekzekutiv”.

Pika 12 të formulohet duke zëvendësuar referencën në ligjin e cituar me “në përputhje me legjislacionin në fuqi”.

Paragrafi i fundit sugjerohet të hiqet, pasi kufizon dhe dobëson rolin dhe kompetencat e **kryetarit**.

Fatmir Xhafaj – Cili është komenti juaj?

Teuta Baleta – Komenti është: nëse do të zgjedhim alternativën e parë apo të dytën, do të shprehemi në varësi të asaj që do të caktohet.

Fatmir Xhafaj – Në rregull. Ramë dakord që në fillim për atë.

Teuta Baleta – Në lidhje me mos heqjen e pjesës hyrëse, ne mendojmë se duke thënë “drejtori i përgjithshëm ekzekutiv”, ezaurohen, sepse dihet se çfarë është. Megjithatë, nuk jemi kundër, me përjashtim të faktit që ne nuk mund të themi “me përjashtim të veprimtarisë së nënkryetarëve”, në qoftë se do të ekzistojnë. Ajo prish hierarkinë e brendshme institucionale dhe krijon ngërçin në veprimtarinë e përditshme. Gjithsesi, kjo do të mbetet në varësi të strukturës.

Fatmir Xhafaj – Ka edhe logjikë.

Teuta Baleta – Lidhur me atë që i propozon bordit për çështje që janë të nevojshme për mbarëvajtjen e veprimtarisë së AMF-së, kryetari mund të propozojë ato çështje të cilat janë të nevojshme për procesin e mbikëqyrjes dhe të rregullimit, sepse këto janë funksionet kryesore të Autoritetit dhe mbarëvajtja e AMF-së është në funksion të dy detyrave kryesore. Pra, nuk mund të kufizohet në këtë. Kështu që nuk biem dakord, sepse kjo dispozitë duhet të ketë një riformulim më të gjerë.

“Nxjerr urdhra dhe udhëzime për të përmbushur kompetencat e tij me karakter ekzekutiv”, këtu jemi dakord dhe ky ka qenë qëllimi, pra për organizmin e brendshëm të institucionit, sepse të tjerat i takojnë bordit.

Për sugjerimin “në përputhje me legjislacionin në fuqi” jemi dakord. Ai referim është bërë sipas sugjerimit të Ministrisë së Drejtësisë.

Me thënë të drejtën, paragrafin e fundit nuk arrij ta kuptoj dot. Ne këtu kemi vënë thjesht mekanizmin se kujt i kalon drejtpërdrejt e drejta për të menaxhuar veprimtarinë e përditshme të Autoritetit nëse mungon kryetari për shkaqe objektive, që të mos kemi periudha shkëputjeje në këtë lloj aspekti. Zakonisht ne lëmë një deklaram me shkrim se kujt i delegohet firma, por supozojmë se jemi në rrethanat...

Fatmir Xhafaj – Ju keni pjesërisht të drejtë, është nënkryetari më i vjetër në moshë apo në detyrë?

Teuta Baleta – Nënkryetari më i vjetër në detyrë, se në moshë na u duk pak si diskriminuese.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

A biem dakord edhe me ndërhyrjet e zonjës?

Miratohet neni 7.

Neni 8.

Ermonela Felaj – Edhe këtu kemi dhënë dy alternativa. E para është ajo që lidhet me strukturën, kurse e dyta kur nuk pranohet struktura me dy nivele.

Neni 16 i ligjit ekzistues formulohet në këtë mënyrë: “Nënkryetarët e bordit janë secili drejtues i njërit prej dy departamenteve kryesore të Autoritetit. Brenda kompetencave të akorduara me vendim të bordit, nënkryetari organizon, drejton dhe përgjigjet për punën e departamentit që drejton. Në mungesë të kryetarit, ose kur ai është në pamundësi objektive për të ushtruar funksionet e tij, bordi autorizon një nga nënkryetarët për ta zëvendësuar përkohësisht kryetarin në ushtrimin e detyrave të tij”.

Teuta Baleta – Për këtë do të shprehem më vonë, meqenëse ka përsëri lidhje me strukturën.

Ermonela Felaj – Për neni 8, që bën fjalë për nenin 17 të ligjit ekzistues, sugjeroj që paragrafi i dytë dhe i tretë të ndryshojnë si vijon: “Bordi miraton rregullat e organizimit dhe të

funkcionimit të këtyre komiteteve. Komiteti i kontrollit mund të emërojë njërin prej anëtarëve të tij si raportues”.

“Raportuesi gëzon të gjitha të drejtat për të kryer inspektim të plotë rreth çështjes, përgatit raporte të hollësishme dhe ia paraqet ato bordit. Nëse vërtetohen shkelje ose mangësi, raporti përmban rekomandime për masat që duhen marrë për rregullimin e gjendjes”.

Teuta Baleta – Jemi dakord me këtë.

(Drejtimin e mbledhjes e merr Armando Subashi.)

Armando Subashi – Jeni dakord me të dyja pikat?

Teuta Baleta – Po.

Armando Subashi – Faleminderit!

Vazhdojmë me nenin 10.

Ermonela Felaj – Te paragrafi i parë i nenit 10 sugjerohet që togfjalëshi “në mënyrë të qëllimshme” të zëvendësohet me togfjalëshin “në mënyrë të paligjshme dhe me faj”.

Armando Subashi – Cili është mendim i ministrisë?

Ervin Mete – Është thjesht diskutim juridik. Ne mendojmë se mund të përdoret edhe termi “keqbesim”, pra togfjalëshi “në mënyrë të qëllimshme” të zëvendësohej me termin “me keqbesim”.

Armando Subashi – “Me keqbesim dhe me faj”?

Ervin Mete – Thjesht termi “me keqbesim”.

Ermonela Felaj – Në fakt, më e mira do të ishte t’i referoheshim Kodit Civil për sa i takon përgjegjësisë për shkaktimin e dëmit dhe të huazonim të njëjtën terminologji që përdor edhe Kodi Civil për këtë gjë.

Ervin Mete – Është një ligj i veçantë për përgjegjësitë jashtëkonraktore të punonjësve të institucioneve shtetërore. Ka një dispozitë specifike për këtë dhe termi që përdoret atje është “keqbesim”. Megjithatë, mund ta shohim edhe më me kujdes dhe të shprehemi.

Armando Subashi – Biem dakord që kjo shprehje të rakordohet me Kodin Civil, duke parë elementet që përmban dispozita atje në raport me këtë gjë. Në fakt, termi “keqbesim” është shumë më i gjerë sesa togfjalëshi që përdori relatorja “në mënyrë të paligjshme dhe me faj”.

Ervin Mete – Ky është qëllimi ynë.

Armando Subashi – Kjo e ngushton shumë. Nëse qëllimi i ligjit është të jetë më i hapur, atëherë mundet që termi “me keqbesim” të jetë më i përshtatshëm.

Ervin Mete – Nëse mundet, dua të bëj një paralelizëm edhe me fushën tatimore. Mundet që shmangia tatimore të jetë në përputhje me ligjin dhe normalisht të kryhet edhe pa faj, por është një shmangie e papranueshme për legjislacionin. Edhe këtu mund të jetë e ligjshme, por transaksionet e kryera me keqbesim, që janë të rrezikshme, nuk mund të pranohen.

Armando Subashi – Neni 11.

Ermonela Felaj – Sipas nenit 11 të projektit, pas nenit 18 shtohet neni 18/1 me këtë përmbajtje, të cilën e keni edhe përpara. Unë do të sugjeroj vetëm një ndryshim në pikën 2, ku thuhet “Autoriteti kryen hetime në emër dhe për llogari të autoriteteve të tjera mbikëqyrëse...” të thuhet “Autoriteti kryen hetime, duke respektuar legjislacionin në fuqi në emër dhe për llogari të autoriteteve të tjera mbikëqyrëse...”.

Armando Subashi – Ministria është dakord me këtë sugjerim?

Ervin Mete – Jemi dakord.

Armando Subashi – Te pika 4 ka edhe diçka tjetër.

Ermonela Felaj – Nevojitet një saktësim në pikën 4. Nëse shprehja “akteve nënligjore” u referohet akteve në fuqi apo akteve nënligjore që do të dalin në zbatim të këtij ligji dhe nëse bëhet fjalë për aktet nënligjore që do të dalin në zbatim të këtij ligji, duhet të saktësohet organi, i cili do të nxjerrë aktet nënligjore, që duhet të jetë kushtetues.

Teuta Baleta – Këto akte nënligjore nuk u referohen akteve të nxjerra në zbatim të këtij ligji, por akteve nënligjore që mund të jenë në fuqi dhe që prekin Autoritetin, pra të nxjerra nga të tjerë.

Ermonela Felaj – Është e qartë.

Armando Subashi – Neni 12.

Ermonela Felaj – Neni 12 lidhet me nenin 20 të ligjit ekzistues, ku propozohet të ndryshohet paragrafi i dytë i këtij neni. Në këtë rast ne vijmë me dy alternativa për AMF-në. Nëse pranohet rekomandimi i Bankës Botërore, siç parashikohet në nenin 5 të projektligjit, si edhe shtesat dhe ndryshimet e paraqitura në ligjin “Për nëpunësin civil” nr. 152, të vitit 2013, i cili ka zgjeruar gamën e kategorive të punonjësve dhe të institucioneve që do të rregullohen sipas ligjit të shërbimit civil, mund të pranohet propozimi për ndryshimin e paragrafit të dytë të nenit 20, vetëm duke bërë sugjerimin që shprehja “akte të tjera nënligjore” të zëvendësohet me “rregulla dhe udhëzime”.

Alternativa tjetër është që, nëse nuk pranohet nga ju propozimi për nenin 5 të projektligjit, sipas këtyre argumenteve që dhamë më sipër, automatikisht bie poshtë edhe neni 12 i projektligjit.

Armando Subashi – Kur kemi diskutuar në parim për aktet nënligjore të ligji tjetër, kemi rënë dakord.

Ervin Mete – Për aktet nënligjore dhe për pjesën e Kodit të Punës është bërë një propozim nga qeveria, që është në parlament, për nxjerrjen jashtë të Autoritetit nga statusi i nëpunësit civil. Nëse ju e gjykoni, mundet që ndryshimi të mos shqyrtohet fare, sepse aktualisht ligji e parashikon që marrëdhëniet e punës të rregullohen sipas Kodit të Punës dhe qartësisht prevalon ligji me tre të pestat. Në momentin që do të do të ndodhë ndryshimi atje, atëherë është i vlefshëm edhe ky, por, nëse nuk ndodh ai ndryshim, rregullimi aktual bie.

Armando Subashi – Pra, ishte fjala për nenin 5 të pjesës së dytë të arsytimit, apo jo?

Ervin Mete – Desha ta rritesh, sepse edhe në nenin 20 aktual flitet përsëri për Kodin e Punës.

Me aktet nënligjore biem dakord.

Armando Subashi – Neni 13.

Ermonela Felaj – Neni 13 është njësoj si neni 12 i projektligjit.

Armando Subashi – Janë të njëjtat sugjerime. A jeni dakord që të ecim me logjikën e nenit 12?

Ervin Mete – Kam përshtypjen se është lënë për një kohë të dytë.

Teuta Baleta – Po, jemi dakord që duhet të trajtohet si neni 12, pra me alternativën e parë.

Armando Subashi – Pra, është e njëjta logjikë si ajo e nenit 12.

Neni 14.

Ermonela Felaj – Neni 14 sjell një ndryshim në nenin 26 të ligjit ekzistues. Në fakt, edhe gjatë relatimit që u bë gjatë mbledhjes së mëparshme të këtij komisioni lidhur me këtë çështje, ne kemi pasur mendimin që krijimi i fondit rezervë, që funksionon edhe në borde të tjera të huaja, forcon pavarësinë dhe i jep më shumë vetëkontroll Autoritetit për të buxhetuar nga burimet e tij financiare.

Jam që këtë ta lëmë në vlerësimin tuaj, përderisa nuk kemi një vërejtje konkrete lidhur me këtë dispozitë. Thjesht jemi në dilemë. Kështu që besoj se ju jeni më afër qëndrimit më të përshtatshëm.

Armando Subashi – Zoti Zëvendësministër, a mund ta hedhim këtë hap?

Ervin Mete – Vlerësojmë se është i nevojshëm, veçanërisht edhe për një logjikë të thjeshtë. Autoriteti mund të kërkojë të shpenzojë më tepër apo të kontrollojë më tepër në kohë krize, sepse në të ardhurat e tij tashmë nuk do të ketë mbështetje nga buxheti, por do të varet vetëm nga të ardhurat që mbledh nga industria. Kur industria është e dobët, pra nuk jep shumë të ardhura, atëherë Autoriteti mund të zgjerohet dhe duhet të jetë më i fortë. Kështu që duhet të ketë një rezervë që të mos kushtëzohet mbikëqyrja e Autoritetit nga fondet që mbledh aktualisht, sepse shkojnë në drejtime të ndryshme. Pra, duhet të jetë fondi rezervë.

Armando Subashi – Neni 17.

Ermonela Felaj – Neni 17 bën fjalë për dispozitën kalimtare. Në fakt, ne do të donim të dinim se çfarë qëllimi keni pasur kur e keni propozuar këtë dispozitë, pastaj do të shprehim qëndrimin tonë. E kemi këtë dyshim, sepse mendojmë se kjo dispozitë krijon përplasje me nenin 6 të ligjit ekzistues, ku parashikohet që ministri i Financave, Këshilli i Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë dhe Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit kanë të drejtë t'i propozojnë Këshillit të Ministrave nga një kandidat për anëtar të bordit të Autoritetit.

Ervin Mete – Së pari, kjo ka qenë në linjë me propozimin siç është. Domethënë, nëse i shohim në tërësi ndryshimet kanë një logjikë. Në qoftë se do të ecim me logjikën e riformatuar, edhe kjo duhet parë. Ideja është se si mund të garantohet një kontroll më i mirë. Ne mendojmë se mund të ishte më shumë garanci për ne nëse Këshilli i Ministrave do të kishte të drejtën të propozonte më tepër sesa ka, sepse aktualisht propozimet janë nga autoritetet e tjera.

(Drejtimitin e mbledhjes e rimerr Famtir Xhafaj.)

Fatmir Xhafaj – Është e qartë.

Ermonela Felaj – Në fund të fundit, përderisa të gjitha propozimet i administron Këshilli i Ministrave nuk kemi ndonjë problem.

Fatmir Xhafaj – Neni 18 “Hyrja në fuqi”.

Ervin Mete – Ju lutem, dua të bëhet edhe një shtesë këtu. Ka një disbalancë në ligjin aktual. Kërkohen kritere pajtueshmërie dhe aftësie për punonjësit, por kriteret që kërkohen për

anëtarët e bordit dhe për autoritetet janë më të relaksuara. Mendojmë se ato që kërkohen për punonjësit duhet të kërkohen edhe për anëtarët.

Fatmir Xhafaj – Madje më të forta.

Ervin Mete – Qoftë edhe për sa i përket konfliktit të interesit, që specifikohet në nenin 20, qoftë edhe atë që kemi vendosur për aftësi, kështu që te neni 5 të shtojmë të njëjtën përmbajtje që ka neni 20 që flet për punonjësit. Domethënë, thjesht për të rritur profesionalizmin dhe paanësinë.

Fatmir Xhafaj – A biem dakord me propozimin?

Miratohet.

Neni 18 miratohet.

Para se ta mbyllim, zoti Zëvendësministër, bëni një koment të përgjithshëm, sepse kemi lënë disa gjëra pezull.

Ervin Mete – Ky ligj, siç e kam thënë edhe kur sqaruam ose bëmë diskutimin në parim të ligjit për sigurimet, vjen në kuadër të kësaj pakete që ne duam të bëjmë për një funksionim më të mirë, më të shëndetshëm dhe më të kontrolluar të sektorit financiar dhe të kësaj specifike të sektorit financiar, e cila mund të sjellë rreziqe për të në tërësi. Logjika e përdorur nga Banka Botërore dhe nga FMN-ja, të cilat janë mbështetëse dhe kanë bërë analizën, sepse në bazë të rekomandimeve të tyre janë bërë, është që duhet të forcohet autoriteti mbikëqyrës dhe rregullator në këtë rast, të forcohet pavarësia dhe mirëfunksionimi i tij, të forcohet baza ligjore e mbikëqyrjes mbi tregun, pastaj të shikohet mundësia edhe e zgjerimit të tregut. Domethënë, kjo është e gjithë logjika.

Për sa u përket ndryshimeve që janë lënë pezull, besoj se ato janë të gjitha në një linjë. Pra, në momentin që do të marrim një vendim si do të ecim përpara, duke e diskutuar këtë edhe me partnerët tanë në këtë rast, atëherë të gjitha ato reflektohen.

Fatmir Xhafaj – Para se ta votojmë në tërësi, dua të bëjmë një gjë të qartë, që besoj se është e rëndësishme, duhet të reflektojmë se për çfarë do të diskutohet edhe me Bankën Botërore për t'i riparë me kujdes riformulimet që do të dalin në fund në relacionin që do t'i përcillet komisionit dhe Kuvendit.

Kush është dakord në tërësi? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet!

Faleminderit, zoti Zëvendësministër, zonja Shehu dhe ju zonja shumë të respektuara, që asistuat gjatë gjithë këtij procesi, për kontributin dhe për ekspertizën tuaj profesionale! Faleminderit kolegëve, medies dhe këshilltarëve për punën që kanë bërë! Punë të mbarë!

E mbyllim mbledhjen.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 14.05.2014 ora 17:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Shqyrtimi i dekretit të Presidentit për emërimin anëtar të Gjykatës së Lartë të zotit Alaudin Malaj.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Blendi Klosi, Bashkim Fino, Ermonela Felaj, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Petrit Vasili, Dashamir Peza, Armando Prenga, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Pirro Lutaj, Vexhi Muçmataj, Spartak Braho, Silva Caka dhe Mark Frroku.

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Tom Doshi, Fatmir Mediu, Arben Ristani, Gjovalin Bzheta, Nard Ndoka, Mhill Fufi, Keltis Kruja, Edi Paloka, Kastriot Islami, Gent Gtrazimiri, Eduard Halimi dhe Tahir Muhedini.

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Mirëmbërëma!

Në këtë mbledhje komisioni kemi shqyrtimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërimin e një anëtari të Gjykatës së Lartë. Me kërkesën e kolegëve, mbledhjen e caktuam pasdite për t'u njohur kolegët deputetë, me të drejtë, me materialin paraprakisht. Kjo ka edhe anën e saj pozitive, për faktin se tashmë të gjithë e kanë marrë raportin, relatimin e përgatitur, po pavarësisht se kolegët e kanë pasur në dispozicion dokumentin, relatorja do të duhet të bëjë një paraqitje të tij.

Fjalën e ka zonja Felaj.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në përputhje me Rregulloren e Kuvendit, në mbledhjen e datës 18 prill 2014 zhvilloi procedurën e shqyrtimit të dekretit të Presidentit të Republikës me nr.8515, të datës 10 mars 2014 për emërimin e një anëtari të Gjykatës së Lartë, përkatësisht të zotit Alaudin Malaj. Bazuar në pikën 7 të nenit 111 të Rregullores dhe në zbatim të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë”, të ndryshuar”, Kryetari i Kuvendit, pasi konstatoi mangësi në shqyrtimin e dokumentacionin shoqërues të kandidaturës, i kërkoi, me shkresën e datës 31 mars 2014, informacion shtesë Presidentit të Republikës.

Me shkresën e datës 2 prill 2014, Presidenti i Republikës i ka përcjellë Kuvendit të Shqipërisë të gjithë dokumentacionin që shoqëronte kandidaturën e zotit Alaudin Malaj, që ndërkohë kishte shërbyer si dokumentacioni, mbi bazën e së cilit, Presidenti i Republikës kishte bërë përzgjedhjen e kësaj candidature.

Ndërkohë dua të bëj me dije komisionin që edhe edhe Kryetari i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut i është drejtuar me shkresë për plotësim të mëtejshëm të dokumentacionit disa institucioneve, si Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Ministrisë së Drejtësisë dhe Inspektoratit të Lartë të Deklarimit të Pasurive, sigurisht për të marrë informacione brenda fushës së kompetencës së tyre ligjore për kandidaturën e zotit Alaudin Malaj.

Duhet thënë që të gjitha këto institucione kanë kthyer *feedback*, pra të gjitha kanë kthyer përgjigje, ndërkohë që përgjigjet i janë vënë në dispozicion të gjithë anëtarëve të komisionit ditën kur u zhvillua seanca dëgjimore me zotin Alaudin Malaj. ILDKP-ja, me shkresën e datës 7.4.2014, ka informuar Kuvendin se në datën 10 mars 2014 është vendosur fillimi i procedurave të kontrollit të plotë për deklaratat e interesave privatë për periudhën 2011-2012, si dhe rikontrolli i plotë i deklaratave të interesave privatë për periudhën 2003-2010 ndaj subjektit të deklaramit, zotit Alaudin Malaj. Pra, ILDKP-ja shprehet nga ana e saj se nuk mund të konfirmojë çfarë është kërkuar nga ana e Komisionit të Ligjeve në lidhje me deklarimet që ka depozituar në vite zoti Alaudin Malaj pranë këtij inspektorati, pikërisht se është duke kryer këto procedura të kontrollit dhe të rikontrollit. Pjesa tjetër e dokumentacionit ka qenë e plotë dhe është dorëzuar në Komisionin e Ligjeve.

Për të realizuar një proces transparent, për të arritur në një vlerësim për meritën dhe plotësimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidatit të dekretuar nga Presidenti i Republikës për anëtar të Gjykatës së Lartë dhe konform Rregullores së Kuvendit, komisioni në datën 18 prill 2014 organizoi një seancë dëgjimore të hapur me zotin Alaudin Malaj. Zotit Alaudin Malaj, gjatë kësaj seance, ju ofrua mundësia të shprehet për veprimtarinë e tij profesionale, si dhe për motivin e konkurrimit të tij për anëtar të Gjykatës së Lartë. Duhet thënë që shqyrtimi i dekreteve të Presidentit të Republikës normohet nga disa akte ligjore, të tilla si Kushtetuta, vendime të Gjykatës Kushtetuese dhe Rregullorja e Kuvendit. Në relacionin që secili prej anëtarëve të komisionit ka përpara, këto janë shprehur në mënyrë të detajuar, kështu që nuk e konsideroj të nevojshme që të citoj paragrafë të tërë të Kushtetutës, të ligjit “Për organizimin dhe funksionimit të Gjykatës së Lartë”, si dhe të Rregullores.

Ndërkohë, dua të them se përzgjedhja e anëtarëve të Gjykatës së Lartë kërkon përmbushjen e disa kushteve ligjore bazë. Pika 1 e nenit 3 të ligjit të Gjykatës së Lartë, që mban titullin “Kushtet dhe kriteret për zgjedhjen e gjyqtarëve”, përfaqëson në vetvete një kusht pa të cilin kandidati nuk mund të zgjidhet në Gjykatën e Lartë. Pra, nëse nuk plotëson kushtin e arsimit të lartë juridik, qenien në punë si gjyqtar për jo më pak se 13 vjet ose si jurist për jo më pak se 15 vjet, përvojë në funksione të caktuara publike, mospasjen e ndonjë mase disiplinore në fuqi, mosqenien anëtar i partive politike në pesë vjetët e fundit dhe mosqenien i dënuar penalisht me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Këto janë pesë kushtet bazë dhe mosplotësimi i njërit prej tyre është i mjaftueshëm për t'u skualifikuar nga procedura e mëtejshme për zgjedhëse dhe për të mos u zgjedhur anëtari i Gjykatës së Lartë. Ky është kuptimi që vetë pika 2 e nenit 3 të ligjit të Gjykatës së Lartë ka parashikuar për vazhdimin e procedurës për zgjedhëse për kandidatët për gjyqtarë të lartë, nëse ata përmbushin kushtet ligjore të parashikuara në pikën 1 të këtij neni. Në rast se kandidati i përmbush të pesta kushtet ligjore, atëherë janë kriteret e tjera, të cilat duhen analizuar, që ligji nga ana e tij i ka përcaktuar si kriteret objektive dhe si kriteret shtesë. Të gjitha kriteret që parashikon ligji si kriteret objektive, ashtu edhe kriteret shtesë janë përcaktuese, së pari, për Presidentin e Republikës, por edhe për Kuvendin e Shqipërisë që, mbi një vlerësim diskret të tyre, të bëjë një renditje objektive të kandidaturave të kualifikuara, me qëllim përmbushjen e standardit kushtetues për një kualifikim të lartë dhe sigurimin e një përbërjeje cilësore dhe të përshtatshme për anëtarë të Gjykatës së Lartë.

Dekreti i Presidentit të Republikës, i datës 10 mars 2014, ka dalë për të plotësuar vakancën e krijuar në trupën e Gjykatës së Lartë, si pasojë e mbarimit të mandatit kushtetues 9-vjeçar të njërit prej gjyqtarëve të kësaj gjykate, zotit Ardian Borani. Mbështetur në pikën 2 të nenit 4, të ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë", procedura për emërimin e anëtarit të Gjykatës së Lartë, që do të plotësonte vakancën e krijuar për shkak të mbarimit të mandatit të gjyqtarit Ardian Dovorani, duhet të fillonte, në fakt, jo më vonë se tre muaj përpara mbarimit të mandatit të tij. Pra, jo më vonë se data 24 nëntor 2013. Në funksion të respektimit të këtij detyrimi ligjor konstatohet se njoftimi i institucionit të Presidentit të Republikës në faqen zyrtare të internetit për fillimin e procedurave për për zgjedhjen kandidaturave për Gjykatën e Lartë është kryer në datën 20.01.2014, pra dy muaj në tejkalim të afatit ligjor.

Në këtë njoftim nuk rezulton se në cilën datë i është përcjellë institucionit të Presidencës njoftimi për krijimin e këtij vendi vakant, njoftim që është detyrim ligjor i kryetarit të Gjykatës së Lartë. Ndërkohë në arsyetimin e dekretit nr.8515, datë 10.03.2014, pasqyrohet fakti se njoftimi nga ana e kryetarit të Gjykatës së Lartë për krijimin e vakancës është bërë vetëm në datën 16.01.2014.

Afati për paraqitjen e kandidaturave, në njoftimin e mësipërm të institucionit të Presidencës, ishte fillimisht data 05.02.2014. Institucioni i Presidencës, në funksion të vlerësimit

të kushteve dhe kriterëve ligjore, ka kërkuar edhe paraqitjen e dokumentacionit mbështetës për secilën prej kandidaturave.

Afati fillestar për paraqitjen e kandidaturave rezulton të jetë shtyrë në datën 03.02.2014 nga ana e institucionit të Presidentit të Republikës me njoftimin publik në faqen zyrtare të internetit. Afati i ri i përcaktuar ishte data 17.02.2014.

Në datën 24.02.2014, në faqen zyrtare të institucionit të Presidentit të Republikës, është publikuar lista e kandidatëve të paraqitur për plotësimin e vendit vakant si anëtar i Gjykatës së Lartë, kandidatë të cilët plotësonin kriteret ligjore që përcakton neni 3, pika 1 e ligjit nr.8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Publikimi i listës është bërë duke prezantuar një renditje të tyre sipas kategorizimit: i) kandidatura nga radhët e gjyqësorit dhe ii) kandidatura që vijnë nga aktiviteti profesional si juristë të shquar.

Me njoftimin publik të datës 28.02.2014, institucioni i Presidentit të Republikës, ka njoftuar se takimet me kryetarët e grupeve parlamentare, për përcaktimin e kriterëve konkrete në përzgjedhjen e anëtarit të Gjykatës së Lartë, siç urdhëron neni 4/1 i ligjit organik të Gjykatës së Lartë, do të zhvilloheshin në datën 04.03.2014.

Pas zhvillimit të këtyre takimeve është nxjerrë dekreti nr.8515, datë 10.03.2014, shqyrtimi i të cilit do të zhvillohet në këtë komision, në përputhje me parashikimet e Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë.

Konkretisht për kandidaturën që është dëgjuar në këtë komision, në aspektin e plotësimit të kushteve ligjore për zotin Alaudin Malaj, nisur nga dokumentacioni i administruar rezulton se përmbush kriteret formale që përcakton ligji për të qenë anëtar i Gjykatës së Lartë.

Në arsyetimin e dekretit nr.8515, datë 10.03.2013 të Presidentit të Republikës, për emërimin e zotit Alaudin Malaj në detyrën e anëtarit të Gjykatës së Lartë, është parashtruar: “...Në kandidaturën e zotit Alaudin Malaj, si një konkurrues që vjen nga radhët e gjyqësorit, vlerësova përvojën dhe vjetërsinë në profesion, si dhe treguesit mbi performancën e tij si gjyqtar dhe si drejtues gjykate. Zoti Malaj ka ushtruar profesionin e gjyqtarit të Shkallës së Parë për rreth 3 vjet dhe prej rreth 17 vitesh ushtron funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit. Prej muajit nëntor 2011 ai kryen edhe funksionin e kryetarit të Gjykatës së Apelit Tiranë.”

Nisur nga rregullimi i ri ligjor i procedurës përzgjedhëse për emërimin e kandidatëve për anëtar të Gjykatës së Lartë, sikundër është folur edhe më parë në raste të ngjashme, komisioni

konstaton se çdo kandidaturë për t'u emëruar si anëtar i Gjykatës së Lartë duhet të përmbushë 5 kushte të natyrës formale-ligjore, kushte pa të cilat nuk mund të bëhesh gjyqtar. Mosplotësimi i njërit prej tyre është i mjaftueshëm për t'u shkualifikuar nga procedura e mëtejshme përzgjedhëse, si dhe për të mos u zgjedhur anëtar i Gjykatës së Lartë.

Në rast se kandidati i përmbush të pestë kushtet ligjore, atëherë janë kriteret e tjera, që duhen analizuar, të cilat ligji i ka specifikuar si “kriteret objektive” dhe si “kriteret shtesë”.

Të gjitha kriteret që parashikon ligji, si kriteret objektive, ashtu dhe kriteret shtesë, i shërbejnë Presidentit të Republikës, por edhe Kuvendit të Shqipërisë.

Në procesin e shqyrtimit e këtyre dekreteve, komisioni vendosi që të marrë parasysh dhe të vlerësojë posaçërisht situatën e re ligjore, që lidhet me ndryshimin e ligjit organik të Gjykatës së Lartë.

Në ndryshimet ligjore të ligjit organik të Gjykatës së Lartë ka gjetur normim dhe procedura e konsultimit të Presidentit të Republikës me përfaqësuesit (kryetarët e grupeve parlamentare) të forcave politike që përfaqësohen në Kuvend.

I njëjti ligj, ai nr. 151/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8588/2000 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë", në dispozitën përkatëse sanksionon jo vetëm fillimin e procesit të bashkëpunimit ndërmjet Presidentit të Republikës dhe kryetarëve të grupeve parlamentare, por vendos edhe disa rregulla, mbi të cilat kryhet ky bashkëpunim.

Konsultimet paraprake ndërmjet Presidentit të Republikës dhe kryetarëve të grupeve parlamentare, sipas nenit 4/1 të ligjit, janë një procedurë ligjore që zhvillohet jo vetëm formalisht, por ajo është shprehje e bashkëpunimit institucional mes Presidentit dhe Kuvendit, me qëllim përzgjedhjen e kandidaturave për Gjyqtarë të Gjykatës së Lartë.

Këto konsultime, për shkak të detyrimit ligjor të lartpërmendur dhe atij që buron nga jurisprudenca kushtetuese, kryhen për të arritur objektiva që qartësisht parashikohen nga norma e së drejtës, si vijon:

- i) për të përcaktuar kriteret konkrete, bazuar në listën e konkurrentëve;
- ii) duke respektuar standardin kushtetues për kualifikim të lartë;
- iii) me qëllim sigurimin e një përbërje cilësore dhe të përshtatshme.

Duke vijuar në analizimin e rregullimeve ligjore, që ligjvënësi i ka bërë procesit dhe finalizimit të tij me dekretimin e anëtarëve të Gjykatës së Lartë nga ana e Presidentit të

Republikës, mbështetur në diskutimet e shumicës së anëtarëve të tij, komisioni në këtë raport gjen me vend të nënvizojë, edhe përpara publikut, një sërë çështjesh.

Me shqetësim dhe përgjegjësi në përmbushjen e funksionit të tij ligjor, që i njeh Rregullorja e Kuvendit të Shqipërisë, Komisioni i Ligjeve konstaton se nga ana e Presidentit të Republikës, pavarësisht qëndrimit të Kuvendit të Shqipërisë, të formalizuar në mosdhënien e pëlqimit për dekretet nr. 8395, datë 22.11.2013 dhe nr. 8396, datë 22.11.2013, edhe në procedurën e finalizuar me nxjerrjen e dekretit nr. 8515, datë 10.03.2014 nuk është respektuar germa dhe fryma e ligjit, përkatësisht neni 4/1 i ligjit nr. 8588/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar” .

Në të tilla rrethana, Komisioni i Ligjeve detyrohet të ritheksojë se shkelja rishtas e dispozitave të ligjit organik nga ana e Presidentit të Republikës, në kryerjen e procedurave për përzgjedhjen dhe emërimin e anëtarit të Gjykatës së Lartë, duhet të evidentohet nëpërmjet këtij raporti dhe të korrektohet nga ana e institucionit përkatës, me qëllim aktualizimin e një bashkëpunimi konkret, luajal, transparent dhe në dobi të mirëfunksionimit të Gjykatës së Lartë, si dhe në dobi të bashkëpunimit të Kuvendit me Presidentin e Republikës.

Duke iu referuar jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, që është pasqyruar edhe më lart në këtë raport, Kuvendi në vitin 2013, me konsensusin e të gjitha forcave politike, kreu ndryshime thelbësore në ligjin organik të Gjykatës së Lartë, si për sa u takon kushteve ligjore e kritereve që do të duhet të plotësojnë anëtarët e Gjykatës së Lartë në momentin e dekretimit të tyre, ashtu edhe për realizimin e një procesi bashkëpunues mes Presidentit të Republikës dhe Kuvendit, në fazën e përzgjedhjes së këtyre kandidaturave.

Për herë të parë në legjislacionin shqiptar, dispozita e nenit 4 pika 6 të ligjit nr. 8588/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, e detyron Presidentin e Republikës të arsyetojë vendimmarrjen e tij që formatizohet me dekretimin e emërimit të anëtarit të Gjykatës së Lartë.

Kjo praktikë e re, është shprehje e vullnetit të ligjvënësit, për të kryer një transpozim në legjislacion të jurisprudencës së konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese që, duke interpretuar dispozitat përkatëse kushtetuese, ka mbajtur qëndrimin se, pavarësisht pushtetit diskrecional në emërimin e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, Presidenti i Republikës duhet të udhëhiqet nga synimi për të siguruar një përbërje sa më cilësore dhe të përshtatshme të këtyre gjykatave. Në arsyetimin e dekretit të Presidentit të Republikës është e domosdoshme që,

me përmbajtjen e re që ka dispozita e nenit 3 dhe 4/1 të ligjit organik të Gjykatës së Lartë, të arsyetohet jo vetëm thjesht mbi plotësimin e kriterëve ligjore, të cilat për nga natyra e tyre janë të një karakteri formal, por kryesisht mbi plotësimin e kriterëve objektivë, atyre shtesë dhe konkretë.

Komisioni gjen me vend të ritheksojë, se i njëjti vullnet politik dhe ligjvënës konstatohet se ka qenë vijues dhe i gjithëpranuar dhe gjatë diskutimit dhe miratimit nismës ligjvënëse që solli ndryshimet në ligjin organik të Gjykatës së Lartë.

Në relacionin shoqërues të kësaj nisme ligjore të paraqitur nga KM arsyetohet se: "...Këto dispozita kanë për qëllim rritjen e cilësisë së trupës gjyqësore dhe rritjen e imazhit të kësaj trupe në sytë e publikut të gjerë, duke krijuar bindjen se personat e përzgjedhur si anëtarë të Gjykatës së Lartë janë elementë të jashtëzakonshëm dhe me një integritet të padiskutueshëm. Për më tepër, për herë të parë matet në mënyrë objektive aktiviteti përzgjedhës i kryer nga Presidenti dhe Kuvendi për plotësimin e vendeve vakante në Gjykatën e Lartë... Neni 4, i projektligjit parashikon zhvillimin e konsultimeve ndërmjet Presidentit dhe kryetarëve të grupeve parlamentare, me qëllim përcaktimin e kriterëve specifike për përzgjedhjen e anëtarëve të Gjykatës së Lartë. Kjo dispozitë është hartuar në përmbushje të një detyrimi kushtetues, që buron nga vendimi 24/2011 i Gjykatës Kushtetuese... Vetëm nëpërmjet një dialogu luajal mes palëve mund të arrihet në përcaktimin e karakteristikave konkrete që duhet të ketë anëtari i Gjykatës së Lartë, edhe duke iu referuar atij moment të caktuar historik..."

Vullneti i ligjvënësit gjen shprehje dhe në raportin e këtij komisioni, kur projektligjin në fjalë me përmbajtjen që ai ka sot, e që u parashtrua më lart në relativitet, ia ka kaluar seancës plenare të Kuvendit për miratim.

Duke iu kthyer zhvillimit të procesit konkret përzgjedhës nga ana e Presidentit të Republikës, siç ai është parashikuar nga neni 4/1 i ligjit organik të Gjykatës së Lartë, konstatojmë se takimet e zhvilluara nga Presidenti i Republikës me kryetarët e grupeve parlamentare, përsëri nuk ishin të karakterit konsultues, siç ligji urdhëron.

Nga këto konsultime nuk është diskutuar, por as përcaktuar (bazuar mbi listën e kandidatëve të kualifikuar nga vetë Presidenti i Republikës), asnjë nga kriteret konkrete që ligji i parashikon si kriterë objektivë dhe si kriterë shtesë, mbi të cilat mund të bëhet diferenca ndërmjet kandidaturave. Moskryerja e procesit konsultues mbi të gjitha kriteret (objektive dhe shtesë), që evidentojnë dhe njëkohësisht diferencojnë kandidaturat e kualifikuara, jo vetëm që nuk arrin të

sigurojë një përbërje cilësore dhe të përshtatshme për gjyqtarin e Gjykatës së Lartë, por kjo bie në kundërshtim të plotë edhe me ligjin.

Kjo shmangie nga thelbi i procesit konsultues, sigurisht që vjen ndesh me interpretimin që ky proces ka gjetur nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese, që e përkufizon atë jo si një konsultim formal, por thelbësor dhe të baraspeshuar.

Ritheksojmë se vetë dispozita e nenit 4 të ligjit organik të lartpërmendur, duke mos lënë hapësirë për interpretime subjektive, urdhëron Presidentin e Republikës, që nëpërmjet procesit të konsultimit, mbi një listë kandidatësh të përzgjedhur paraprakisht, të arrijë në përcaktimin e kritereve konkrete, të cilat duhet më pas të gjejnë pasqyrim të detajuar dhe të argumentuar edhe në arsyetimin e dekretit përkatës.

Komisioni i Ligjeve, sërish konstaton se arsyetimi i këtij dekreti mungon të parashtrojë: i) përvojën e veçantë të kandidatit në një fushë të caktuar të së drejtës; ii) treguesit shkencorë, ku përfshihen botimet dhe artikujt shkencorë në fushën juridike; iii) përbërjen e trupës gjyqësore, në momentin e emërimit të kandidatit, duke synuar balancën ndërmjet përvojave personale të anëtarëve, të para këto si kritere konkrete, që do të duhej të ishin identifikuar përgjatë procesit konsultues.

Nga ana e Presidentit të Republikës, si gjatë kryerjes së procesit konsultues, ashtu dhe në finalizimin e vendimmarrjes së tij në dekretimin e anëtarit të Gjykatës së Lartë, është anashkaluar edhe “momenti historik”. Ky element i procesit të përzgjedhjes së anëtarëve të Gjykatës së Lartë, që do të duhej vlerësuar si një kriter konkret për t’u konsultuar me përfaqësuesit e grupeve parlamentare, është lënë mënjanë.

Në përfundim të të gjitha këtyre që u thanë, ne i sugjerojmë Kuvendit të Shqipërisë, në emër të këtij komisioni, mosdhënien e pëlqimit për dekretin e Presidentit të Republikës për emërimin e një anëtari të Gjykatës së Lartë.

Komisioni e rifton Presidentin e Republikës që, në respekt të funksionit dhe misionit kushtetues që ka, të rifillojë procedurat përkatëse ligjore për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Gjykatës së Lartë, duke respektuar detyrimet kushtetuese ligjore me një objektiv kryesor, krijimin e një raporti bashkëpunimi luajal dhe institucional edhe në respekt të kompetencës vendimmarrëse dhe përcaktuese që ka Kuvendi i Shqipërisë, me qëllim përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Kushtetuta, ligji dhe jurisprudenca e Gjykatës

Kushtetuese, duke shmangur çdo pengesë, e cila mund të rrezikojë dhënien e pëlqimit për emërimin e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zoti Braho e ka fjalën.

Spartak Braho – Në relacion thuhet që komisioni i është drejtuar ILDKP-së për të vënë në dispozicion të komisionit deklaratën e pasurisë së kandidatit Alaudin Malaj dhe kjo ende nuk ka ardhur. Ka ndonjë pengesë që ne të vazhdojmë ta shqyrtojmë në qoftë se nuk vjen kjo deklaratë?

Fatmir Xhafaj – Ka ardhur përgjigja.

Komisioni në përmbushje të detyrës, unë në cilësinë e kryetarit të Komisionit, u jam drejtuar të gjitha institucioneve që duhet të shprehen në një rast të tillë, përfshi këtu edhe Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe inspektori i Përgjithshëm, në një shkresë me nr. 1842, datë 7.4.2014, ka theksuar se të gjitha deklaratat e gjyqtarëve janë në një proces verifikimi. Për të parë konfliktin e interesave ka filluar procedura e kontrollit të plotë për deklaratat e interesave private periodike dhe vjetore për periudhën 2001-2012, si dhe rikontrolli i plotë i kërkesave për të gjitha subjektet, për këtë kanë bërë edhe në një deklaratë publike. Ky është një proces që do të zgjasë dhe në përfundim të tij do të bëhen vlerësimet për të gjithë gjyqtarët. Kjo është deklarata që ka bërë inspektorati dhe ne nuk mund...

Spartak Braho – Pra, në këtë rast nuk ka ardhur.

Fatmir Xhafaj – Ai është shprehur që ky është qëndrimi im.

Spartak Braho – Na pengon, apo jo?

Fatmir Xhafaj – Jo, nuk na pengoi edhe në rastin e mëparshëm kur inspektorati nuk solli fare përgjigje dhe ne e shqyrtuam në komision. Së paku ne nuk e konsideruam si pengesë dhe ju përmbajtëm përgjigjeve që dhanë personat e thirrur në interpelancë, besueshmërisë së përgjigjeve të tyre.

Besoj se duhet të kenë qenë të njëjta dhe në vlerësimin që ka bërë pastaj edhe Presidenti i Republikës.

Gjithashtu, dua t'ju bëj me dije, meqenëse më bëtë një pyetje për këtë fakt, që ne, gjithashtu, i jemi drejtuar Presidentit të Republikës dhe i kemi kërkuar, me një kërkesë për të

dhënë shpjegime plotësuese, që në respekt të nenit 4, pika 1 të ligjit nr. 8588, të vitit 2000 ““Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë”, të ndryshuar”, lutemi të na bëni me dije po ashtu për kriteret objektive që u përcaktuan në konsultimin e zhvilluar mes jush dhe kryetarëve të grupeve parlamentare, të tilla që sigurojnë një kualifikim të lartë, përbërje cilësore dhe të përshtatshme të Gjykatës së Lartë dhe që përmbushen nga kandidaturat. Ky është detyrim ligjor i Presidentit të Republikës dhe një nga ndryshimet thelbësore që u bë në ligjin e Gjykatës së Lartë vitin e kaluar, por që nuk është përmbushur, për fat të keq, nga Presidenti i Republikës në shqyrtimin, në procesin përzgjedhës, në vlerësimin e kandidaturave dhe në reagimin që ka bërë ndaj Kuvendit. Në përgjigjen që Presidenca ka dhënë përmes sekretarit të Përgjithshëm nuk i përgjigjet drejtpërsëdrejti kërkesës së bërë nga ana e Kuvendit.

Unë mendoj se edhe kjo në vetvete përbën një injorim të Kuvendit nga ana e Presidentit të Republikës, të ligjit, të detyrimeve që ka Presidenti në këtë proces, duke theksuar se është e rëndësishme. Besoj se është e qartë, se edhe relacioni, edhe shqyrtimi nuk kanë në fokus gjyqtarët, ashtu si edhe radhën e parë, për ne është i rëndësishëm një proces në pajtim me Kushtetutën, në pajtim me ligjin, sepse vetëm një proces i ndërtuar në mënyrë kushtetuese, bazuar në frymën e Kushtetutës, bazuar në interpretimin që kanë bërë vendimet përkatëse të Gjykatës Kushtetuese, mbështetur fort në rregullimin që ka bërë ligji, duke bërë parashikime konkrete për Kuvendin dhe për Presidentin, do të mund të realizojë këto standarde, që ne të mund të arrijmë atë që ka kërkuar ligji dhe që kemi interes të gjithë për të garantuar një përbërje sa më të mirë të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese dhe të gjitha organeve të pushtetit gjyqësor, që rrjedhin dhe burojnë nga vullneti i ligjvënësit. Procesi është një proces shumë i rëndësishëm që nuk mundet të zhvillohet me një aktor. Kuvendi në asnjë rast nuk mund të jetë noteri që të noterizojë vullnetin e Presidentit, cilido qoftë në atë funksion.

Përkundrazi, ligji, me ndryshimet që ka bërë maxhoranca e kaluar së bashku me maxhorancën e sotme, opozitën e djeshme, që e ka votuar në mënyrë konsensuale, kërkon luajalitet në këtë marrëdhënie, i njeh rol të rëndësishëm përcaktues si Presidentit edhe Kuvendit dhe kërkon bashkëpunim, jo imponim ndërmjet palëve, në mënyrë që të garantojë një proces sa më cilësor dhe përzgjedhje sa më cilësore në raport me Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën Kushtetuese.

Zoti Braho e ka fjalën.

Spartak Braho – U bë i dyti rast që Presidenti i Republikës, të paktën sipas argumenteve që jepen edhe në relacionin e kandidaturës së sjellë disa muaj më parë, por edhe në këtë relacion, shkel rëndë Kushtetutën, shkel rëndë vendimet interpretuese të Gjykatës Kushtetuese dhe në këto kushte, unë mendoj që ndaj Presidentit të Republikës duhen filluar procedurat e shkarkimit. Nuk ka rrugë tjetër dhe ne nuk kemi pse i bëjmë thirrje Presidentit, siç thuhet në relacion, që ta riftojmë të respektojë misionin kushtetues. Ky Presidenti jo vetëm këto dy herë, por sa të jetë gjallë do të vazhdojë të na sjellë këto lloj dekretesh të argumentuara në këtë mënyrë. Megjithatë, kjo është një çështje për të cilën nuk jemi mbledhur sot, por që mua më detyron ta them.

Së dyti, ashtu siç shprehet edhe relacioni, te kandidati, unë nuk shikoj asnjë lloj rrethane ligjore që nuk përmbush të gjitha kriteret apo kushtet për të qenë anëtar i Gjykatës së Lartë dhe kjo, siç thashë, evidentohet hollësisht në relacion, qoftë edhe formalisht. Ajo që mbizotëron te relacioni është se defekti në argumentet në relacion për mosmiratimin e dekretit janë vetëm ato parregullsi të Presidentit, i cili ndan pikëpamje tjetër për interpretimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe të ligjit, pasi ai nuk njeh as kriteret shtesë, as ato konkrete, as specifike, as dialogun luajal, as momentin historik.

Çështja është se ky President nuk njeh. Ne do të vazhdojmë të merremi me edukimin e Presidentit?! Është naivitete. Ne nuk e edukojmë dot këtë President, kjo dihet, megjithatë e vetmja alternativë është ajo që mbetet në atë që thashë, ne duhet të fillojmë procedurat për shkarkimin e tij.

Së fundi, unë doja të theksoja faktin se për shkak të veprimtarisë dhe përgjegjshmërisë, të shumë arsyeve, por qoftë edhe të Presidentit, të sistemit të drejtësisë, veçanërisht Gjykata e Lartë dhe Gjykata Kushtetuese kanë hyrë në handikap. Ne kemi vende bosh, por kemi edhe gjyqtarë në këto dy institucione që u ka mbaruar mandati dhe që vazhdojnë gjykojnë në kundërshtim me ligjin, në kundërshtim me Kushtetutën. Kjo është të luash mendsh dhe, zoti Xhafaj, ne na lind për detyrë ta rregullojmë këtë situatë, jemi komisioni më i rëndësishëm që ka Kuvendi, ndaj duhet të vrasim mendjen që t'i japim rrugëzgjidhje kësaj çështjeje të rëndësishme.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Unë jam dakord që komisioni duhet, përtej gjyqimit të dekretit konkret, të reflektojë për këtë situatë, që nuk është thjesht situata me një dekret, por ajo që ka sot gjyqësori shqiptar, që ka sot sistemi i drejtësisë, që ka një mungesë të lartë, të jashtëzakonshme besueshmërie në radhë të parë nga publiku, por edhe nga partnerët. Jo më larg se përpara pak

ditësh Këshilli i Ministrave i Bashkimit European në një dokument nënvizonte si një nga çështjet themelore, forcimin e shtetit të së drejtës, problematikat e rënda që ka sot sistemi në tërësi e pushteti gjyqësor në veçanti dhe nevojën e madhe që ka për ndërhyrje. Në këtë kontekst ne nuk na lejohe pritshmëria, ka nevojë, jam shumë dakord, për të reaguar, për të reaguar përmes ndryshimeve të rëndësishme ligjore, institucionale, që duhet të zgjidhin jo thjesht ngërçet e krijuara për shkak të mosrespektimit të Kushtetutës dhe ligjit, por edhe për shkak të problematikave që janë krijuar në gjyqësor për shkak të dominimeve politike, të përzgjedhjeve selektive klienteliste, të cilat reflektojnë drejtpërdrejt në problematikën e mprehtë që kemi sot në pushtetin gjyqësor dhe në sistemin e drejtësisë në veçanti.

Pa dyshim, unë do të dëshiroja që Presidenti i Republikës të mos ndjekë rrugën e qëndrimit të mëparshëm ndaj Kuvendit dhe vetë këtij komisioni me refleksime emocionale, me frymëzim politik, duke sulmuar Kuvendin e Shqipërisë, pushtetin legjislativ, ashtu siç bëri pak muaj më parë, por ka nevojë që në radhë të parë të reflektojë ai dhe të gjithë për respektimin e Kushtetutës, vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe të ligjit mbi Gjykatën e Lartë në rastin konkret. Nga ana tjetër, edhe ne kemi nevojë, jam shumë dakord për të reflektuar dhe unë besoj se ne do të duhet shumë shpejt të hyjmë në një proces të ndryshimit të kuadrit ligjor, për t'u dhënë zgjidhje disa elementeve bllokues, por kryesorja është për të ndërtuar një proces përzgjedhës, shumë cilësor, larg ndikimeve politike, klienteliste që dëmtojnë cilësinë e formimit të trupave gjyqësore, veçanërisht të Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese. Janë hapësirat, ka modele shumë të mira, edhe në vendet e Bashkimit European, atje ku ne dëshirojmë dhe kërkojmë të integrohemi, që i kanë këto procese shumë më transparente dhe kryesorja, shumë më profesionale që ju garantojnë përzgjedhje më cilësore dhe qëndrueshmëri të institucioneve të pushtetit gjyqësor. Por sot jemi për të gjykuar për dekretin konkret, për këtë proces që kemi, i cili, besoj se biem dakord, nuk ka respektuar ligjin në radhë të parë, kërkesat e ligjit, ligj i cili, me ndryshimet e bëra vitin e kaluar, kërkon që të ketë një marrëdhënie krejt tjetër ndërmjet Presidentit dhe Kuvendit, një marrëdhënie bashkëpunimi, që mbështetur në vlerësimin e kritereve, të kushteve ligjore bazë, të kritereve objektive, por edhe kritereve shtesë mbi listën e kandidatëve konkretë, ndërkohë që kjo marrëdhënie, ky vlerësim ka munguar tërësisht në këtë proces, gjë që e bën atë një proces në kundërshtim me ligjin.

Në këto kushte, ne nuk mund të mbështesim dhe nuk mund t'i hapim rrugë një procesi që bie në kundërshtim me parashikimet kushtetuese dhe ligjore.

Për këto arsye ju ftoj që të votojmë dhe të mbështesim propozimin e bërë.

Kush është dakord me propozimin e bërë nga relatorja për mosdhënien e pëlqimit për dekretin e Presidentit të Republikës? Kundër? Nuk ka. Abstenim? 1 abstenim.

Me shumë miratohet qëndrimi i Komisionit për t'iu përcjellë seancës plenare.

Faleminderit!

Mbyllim mbledhjen.